

Nderprerja e furnizimit nga Furnizuesi dhe Rilidhja

Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit,:

Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit, 48 orë përpara.

Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit.

Nëse Klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 12, atëherë Furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike sipas pikës 6.1.2, duke njoftuar me shkrim klientin.